



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 801/Prot.
12

Rrëshen me, 26 . 02 . 2021

V E N D I M

Nr. 19 datë 24. 02. 2021

PËR

“MIRATIMIN E RIKONSTRUKSIONIT DHE ZGJERIMIT TË RRUGËS KËMBËSORE, NË RRUGË AUTOMOBILISTIKE, QË FILLON NGA AKSI I RRUGËS BULSHIZES NR. 03200002 DERI NË BANESËN E FUNDIT TË FSHATIT BULSHIZE, NJËSIA ADMINISTRATIVE RUBIK, 4603, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 6, gërma “i”, të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (të ndryshuar), ligji nr.57/2020 “Për pyjet”, dhe projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë (drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit), në këshillin bashkiak, kërkesës nr. 2808 prot, datë 02.09.2020 adresuar bashkisë Mirditë, si dhe projekt/vendimin e kryetarit të bashkisë, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë;

V E N D O S I:

1. Miratimin e rikonstruksionit dhe zgjerimit të rrugës këmbësore në rrugë automobilistike, që fillon nga aksi i rrugës Bulshizes nr. 03200002, deri në banesën e fundit të fshatit Bulshize, njësia administrative Rubik, 4603, Bashkia Mirditë.
 - Segmenti i rrugës ka një gjatësi $L = 1\ 200$ ml, gjërësi kaluese 4 ml, dhe shtrihet në pasurinë me nr. pas 143/1 Zona Kadastrale nr. 1314 me indeks HTR K – 34 – 76 - (169 – D), Sh 1: 2, 500.
2. Bashkëlidhur, raporti teknik, plani i vendosjes së gjurmës së rrugës Sh 1: 7 500, planimetria Sh 1:7 500, pjesë e këtij vendimi.
3. Punimet për rikonstruksionit dhe zgjerimit të rrugës ekzistuese automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe biznesi.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

4. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe prone e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.
5. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, garkohet bashkia Mirditë, (drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit)

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"(të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.


SEKRETAR

Gasper TOPOLLAJ



KRYETAR

Pjeter PJETRI





BASHKIA MIRDITË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

07.18.02.2021

№ 801/1, pub

R A P O R T

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK TË SIPËRFAQES PYJORE/KULLOSORE NË ADMINISTRIM
TË BASHKISË MIRDITË, NJËSIA ADMINISTRATIVE RUBIK**

(Rehabilitimi dhe zgjerimi i plotë i rrugës auto, me gjatësi prej 1.2 km, gjurmë ekzistuese, që fillon nga aksi i rrugës së Bulshizë nr.03200002 deri në banesen e fundit të fshatit Bulshiz, njësi Administrative Rubik, 4603, bashkia Mirditë.)

Në zbatim të Urdhërin nr. 44 datë 16.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë nr 749 Prot, date 16.02.2021; lidhur me studimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore mbi rikonstrukcionin dhe zgjerimin e rrugës që përshkon gjurma e projektit te rruges që fillon nga aksi i rrugës së Bulshizë nr.03200002 deri në banesen e fundit , njësi administrative Rubik; grupi i punës i përbërë nga; Gjovalin Nikolli, Preng Nikolli dhe Eneida Nikolli, pasi u njohën me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë, administruan dokumentacionin teknik të gjurmës së rrugës, realizuan verifikimin e objektit në terren, të dhënat në rregjistrin kadastral të pyjeve/kullotave bashkiake, dhe planin e rregullimit të teritorit të bashkisë Mirditë, konkluduan si më poshtë.

Mbështetur në të dhënat e grumbulluara në dokumentacionin Teknik të sipër cituar, rezulton që sipërfaqja pyjore/kullosore që përshkon gjurma e rrugës është rreth 0.48 ha, fond pyjor/kullosor, me gjatësi rreth 1200 ml (1.2 km) dhe gjërësi mesatare rreth 4 m, në ngastrat/nëngastra pyjore nr.1b, Ekonomin pyjore/kullosore "Grykat e Përroit të Velës", në administrim të, bashkisë Mirditë, njësi administrative Rubik.

Nga përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi ngastra pyjore 1b, rezulton tokë me bimësi pyjore në trajtë shkurreje të llojit dushqe, shqop, shkozë etj, dhe rrallë drurë të rritur, me zhvillim të dobët të llojit dushqe.

Sipërfaqja që përshkon kjo gjurmë rruge, është për ty kthyer nga rrugë kembësore ekzistuese në rrugë automobilistike, nga aksi i rrugës Bulshiz nr.03200002 deri per tek banesa e fundit.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin teknik dhe të verifikuara në terren, nuk e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverisjes dhe treguesit kryesor të sipërfaqes pyjore/kullosore bashkiake.


Rikonstruksioni i plotë dhe vënija në funksion i këtij segmenti rrugë auto pyjore, i shërben mjaftueshëm jo vetëm nevojave të përditëshme të komunitetit të kësaj zone, për rastet e emergjencave civile, shërbimin zjarrfikës në raste zjarri në pyje, por dhe në rritjen e efikasitetit të strukturave të shërbimit civil në përgjithësi, dhe të strukturave ligjzbatuese në monitorimin dhe kontrollin e teritorit në veçanti.

Nga matjet dhe vlerësimet e përafërta në sipërfaqen që zë kjo gjurmë rrugë, vërehet se mund të vlerësohet një sasi prej rreth 9 m³ materiali drusor, në asortimentin dru zjarri të forta, me një tarifë prej 500 lek/m³.


Ky akt mbahet në katër kopje dhe është pjesë e dokumentacionit teknik të administruar në D.P.ZH.T.Strehimit dhe në Drejtorinë Juridike në Bashki.

PËRPILUESIT E KËTIJË RAPORTI

Ing.Gjovalin Nikolli



Ing.Preng Nikolli



Ing.Eneida Nikolli



K O N F I R M O I

K R Y E T A R I

Ndrec DEDAJ



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al